



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.01.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore””.
2. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Evis Kushi, Elona Hoxha, Vasilika Hysi, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Alket Hyseni, Klajda Gjoshja dhe Rudina Hajdari.

Mungojnë:

Tritan Shehu, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Edmond Panariti, Ervin Bushati, Ditmir Bushati dhe Reme Lala.

Të ftuar:

Pandeli Majko, Ministër i Shtetit për Diasporën

Elona Bano, Drejtore e Kabinetit

Soana Jaupllari, Drejtore e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Politikën e Jashtme.

Në rendin e ditës kemi diskutimin për miratim të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore””, si dhe çështje të tjera (nëse ka). Propozimi vjen nga Ministria e Shtetit për Diasporën.

Kemi të pranishëm në komision ministrin Majko.

Mirë se erdhe, zoti Majko! Është kënaqësi të të kemi rishtas këtu!

E ftuar është zonja Bano, drejtore e kabinetit, si dhe zonja Jaupllari.

Mirë se vini!

Propozimi që vjen ka të bëjë me disa elemente, të cilat, zoti Ministër, jeni i lutur të na i shpjegoni me dy fjalë.

Fillimisht fjala është për ju dhe më pas për relatorin, zotin Shameti.

Pandeli Majko – Faleminderit, kryetare e komisionit!

Faleminderit, kolegë!

Ju kërkohet edhe një herë ndjesë për vonesën për arsye objektive!

Projektligji që keni përpara vjen në kuadrin e masave që po marrim për ngritjen e një infrastrukture institucionale të domosdoshme për zhvillimin e lidhjeve të diasporës me vendlindjen.

Gjatë kësaj periudhe, falë edhe ndihmës suaj, parlamenti ka kaluar tri ligje në fushën e diasporës: ligjin “Për diasporën”, ligjin “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, si dhe dhe ligjin “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës”.

Po gjatë kësaj periudhe, qeveria ka kaluar edhe Strategjinë Kombëtare të Diasporës, e cila parashikon masat e një plani veprimi të rëndësishëm deri në vitin 2024. Pjesë e kësaj janë edhe ndryshimet që kanë të bëjnë me infrastrukturën e pushtetit lokal.

E thënë me gjuhë pak më të thjeshtë, është shumë e rëndësishme që njerëzit, të cilët duan të ndërtojnë lidhje me vendin e origjinës, pra me vendlindjen, duhet të kenë edhe infrastrukturën administrative, që t’u përgjigjet për këtë marrëdhënie të kërkuar.

Shpesh, më parë, por edhe tani, pa hyrë në fuqi ky ligj, ka pasur elemente të natyrave të tilla, të marrëdhënieve të shtetasve shqiptarë që kthehen në vendlindje dhe duan të rifillojnë një jetë normale në vendlindje, që kanë qenë të huaj në vendin ku kanë migruar dhe ndihen të huaj edhe në vendlindjen e tyre.

Sigurisht, ne kemi krijuar disa institucione, siç jua thashë edhe pak më parë, por të gjitha këto institucione qendrat dhe zyrat e tyre i kanë në Tiranë dhe jo të gjithë shqiptarët janë nga Tirana. Ata janë nga Kukësi, Durrësi, Shkodra, Saranda, Gjirokastra... Normalisht, ata duhet të kenë pika komunikimi edhe me administratën lokale, që do të jenë pikërisht këto struktura, këto zyra të veçanta të diasporës dhe migracionit.

Ndërkaq, duam të shtyjmë edhe pushtetin lokal të ndërmarrë aksione, bazuar edhe në ndryshimet ligjore, për t'i dhënë më shumë hapësirë në veprimtarinë e tij marrëdhënies me diasporën dhe migracionin.

Ka shumë njerëz sot në migracionin shqiptar, të cilët do të donin të vinin për arsye që kanë të bëjnë me identitetin, për t'u thënë fëmijëve se nga vijnë dhe cilat janë arsyet e largimit të tyre, por, gjithsesi, duke mbajtur komunikimin me atë që quhet identitet. Sot, në këtë globalizëm, kjo është shumë e rëndësishme, jo për ata që kanë ikur, por sidomos për brezin e dytë dhe të tretë, të cilët rrezikohen edhe nga asimilimi.

Dëshiroj t'ju informoj se ky projektligj është diskutuar që në verën e vitit të kaluar. Pse kaq gjatë? Për një arsye shumë të thjeshtë: ky projektligj nuk mund të kalonte në mënyrë të njëanshme nga qeveria dhe të vinte në Kuvend thjesht si një akt mekanik, por duke qenë se prekte marrëdhëniet e pushtetit lokal, ai është diskutuar dhe duhej të diskutohej se s'bën edhe me këshillin e marrëdhënies të pushtetit lokal me qeverinë. Muajt e verës ne kemi pasur takimin e radhës mes përfaqësuesve të qeverisë në këtë këshill edhe me pushtetin lokal, ku u ftova së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme, atë të Financave që të merrnim pjesë në këtë mbledhje dhe tëi diskutonim me detaje këto ndryshime.

Dëshiroj të informoj Komisionin e Jashtëm se të gjitha këto ndryshime kanë edhe miratimin e këtij këshilli me konsensus të plotë, sepse në këtë këshill, siç e dini përfaqësuesit janë jo vetëm njëngjyrësh por janë të majtë, të djathtë dhe u vlerësua si një ndryshim shumë i rëndësishëm, i arsyeshëm, i cili u përgjigjet interesave të komuniteteve, që përfaqësojnë bashkitë. Janë komunitete, ku të gjithë jemi të vetëdijshëm se nuk fillojnë vetëm tek ata që jetojnë në Shqipëri, por edhe tek ata që jetojnë jashtë vendit. Nëse Shqipëria, Kuvendi po diskuton me seriozitet reformën zgjedhore, ku diskutohet e drejta e votës së shtetasve tanë jashtë vendit, kjo nuk duhet të mbetet një votë eterike, por duhet t'i përgjigjet edhe me një strukturë të qartë administrative, e cila fillon nga pushteti lokal dhe përfundon në pushtetin qendror. Të gjithë këta shtetas që nuk jetojnë në Shqipëri, jo vetëm ata, por edhe "shtetas" të huaj, por me kombësi shqiptare e kanë të nevojshme këtë hallkë të rëndësishme edhe në pushtetin lokal, jo vetëm për të marrë informacionin e nevojshëm kur kanë të bëjnë me regjistrime, me hapjen e një biznesi apo elemente të natyrave të ndryshme, por do të nxisin

edhe pushtetin lokal nëpërmjet këtyre zyrave që të organizojnë aktivitete, të cilat kanë të bëjnë jo vetëm me bashkinë brenda territorit të saj, por edhe jashtë territorit të saj, pasi një pjesë e organizatave të komuniteteve shqiptare shpesh janë të organizuara dhe mbi bazën e zonave, qyteteve nga vijën. Këto do t'u shërbejnë më fort lidhjeve të vendlindjes me komunitetet shqiptare jashtë vendit.

Për çdo element jam i hapur të diskutojmë me të gjithë kolegët, nëse kanë pyetje dhe shqetësime të natyrave të ndryshme.

Mimi Kodheli - Faleminderit, zoti Ministër!

Fjala është për relatorin, zotin Shameti. Pastaj do të kalojmë te pyetjet.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Sikurse ministri për Diasporën e parashtroi në fjalën e tij, ky projektligj ka për qëllim ndërhyrjen në ligjin nr.139 të vitit 2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”. Është një ndërhyrje që ka të bëjë vetëm me ngritjen e zyrave përkatëse që do të koordinojnë veprimtarinë e diasporës në të gjitha organet e qeverisjes vendore.

Sikurse e parashtroi zoti Majko mendoj se jemi disi të vonuar në këtë ndërhyrje për ato arsye që edhe ministri i ngriti dhe i përmendi këtu, por është më mirë vonë sesa kurrë. Kjo ndërhyrje në ligjin “ Për vetëqeverisjen vendore” është e domosdoshme. Ngritja e këtyre zyrave për koordinimin e veprimtarive të diasporës në të gjitha organet e vetëqeverisjes vendore është e domosdoshme në dy aspekte: nga njëra anë për të rikthyerit në secilën prej njësive të vetëqeverisjes vendore dhe nga ana tjetër është edhe lidhja, afrimiteti shpirtëror që ekziston midis diasporës dhe të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore, pasi si për pjesën e investimeve, të hapjes së një biznesi, qoftë edhe për filantropi, për ndihmën e vendit të origjinës, të gjithë shqiptarët e diasporës duhet patjetër të kenë një zyrë koordinimi në secilën njësi të vetëqeverisjes vendore.

Gjuha e përdorur në dispozitat që janë paraqitur është e thjeshtë, e kuptueshme dhe nuk ka asnjë ekzagjerim në kompetencat që u lihen zyrave të ngritura në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në këto kushte, i ftoj të gjithë anëtarët e komisionit që t'i miratojmë këto ndryshime në ligjin përkatës.

Nga ana tjetër, dua të theksoj se ligji nuk ka asnjë efekt financiar në kuptimin e efekteve që mund të sjellë.

Për sa më sipër ju ftoj të gjithëve që ta mbështesim unanimisht.

Mimi Kodheli – Po, zonja Gjoshë.

Pastaj zonja Gjermanji dhe kolegët me radhë.

Klajda Gjosha - Përshëndetje, zoti Ministër!

Faleminderit që jeni sot këtu!

Unë i kam parë me kujdes ndryshimet që keni propozuar në projektligjin “Për vetëqeverisjen vendore”. Në parim, patjetër është një ide e mirë që të ketë strukturë të posaçme, e cila kujdeset për të gjitha shërbimet apo informacionet e nevojshme për diasporën. Problemi im qëndron te mënyra sesi ju e parashtroni dhe sa realistë jemi ne me këto ndryshime që bëhen sot në këtë projektligj.

E para, mënyra sesi janë parashtruar ndryshimet. Nuk e di nëse ka pasur një konsultim me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme. Këtë nuk e shikoj dhe besoj se ndryshimet do të ishin paraqitur ndryshe, nëse do të kishte një konsultim të tillë, ndoshta edhe me Ministrinë e Financave dhe me atë të Ekonomisë.

Ju shpreheni se këto struktura do të kryejnë disa detyra të posaçme që kanë të bëjnë me informacionin për biznesin, pra sesi diaspora mund të vijë dhe të ndërtojë urat e biznesit brenda vendit apo një funksion tjetër që ju e quani të rëndësishëm, por që unë e shoh paksa të pamundur që qeverisja vendore të kryejë organizimin e aktiviteteve brenda dhe jashtë vendit.

Te pjesa “jashtë vendit”, në fakt, unë doja t’ju pyesja, sepse edhe vetë projektligji “Për qeverisjen vendore” nuk e përmban këtë funksion për strukturat përkatëse të bashkive të vendit, jo më ta kryej këtë jashtë vendit me struktura, të cilat, në fakt, nuk janë të posaçme. Ju thoni se do ta kryejnë ata individë apo ajo administratë, e cila është e emëruar në këto momente dhe që ka të tjera funksione të përcaktuara, përveç detyrës që duam t’i shtojmë sot, që ka lidhje me diasporën.

Unë nuk e shoh me vend. Do të doja të ishin ngritur struktura të posaçme. Nuk besoj se problemi qëndron te fakti se nuk ka komplikacione financiare, nuk duhet të ketë shtesa financiare, se t’ju them të vërtetën ne e kemi çuar borxhin në 83% dhe nuk besoj se ka mbetur puna te një apo dy individë që mund t’i shtohen administratës së qeverisjes vendore. Besoj se duket të ketë njerëz të dedikuar, njerëz të trajnuar, të cilët mund të kryejnë funksione të mirëpërcaktuara.

Ne e kemi provuar. Në të gjitha bashkitë kemi marrë nga një specialist që ka pasur një detyrë të përcaktuar, i kemi shtuar detyra, e kemi bërë specialist të barazisë gjinore, i kemi shtuar detyra për dhunën në familje dhe kjo gjë nuk ka funksionuar. Imagjinoni tani, të merrni prapë po të njëjtët specialistë dhe t’u thoni që të kryejnë edhe detyrën e diasporës. Kjo nuk është e drejtë. Nuk mund të funksionojë shteti kështu. E kemi provuar dhe kemi shkatërruar ministritë, i kemi bashkuar, një specialist sot bën 5-6 detyra, prandaj institucionet tona nuk funksionojnë.

Po e përsëris, se nuk besoj që ka mbetur te shtesat financiare që mund të kemi ne për një individ të caktuar, që mund të trajnohet dhe mund të kryej këtë detyrë.

Kur administrata jonë vendore nuk e kryen funksionin për të dhënë informacione për bizneset vendase apo për cilindo shqiptare që jeton brenda vendit, imagjinoni që ta bëjë edhe për diasporën.

Unë mendoj se projektligji ka disa probleme dhe ndoshta duhej të ishte konsultuar më mirë. Në parim jam shumë dakord. Nuk është ide e pavlefshme, patjetër që ka vlerë, por besoj se duhet menduar në mënyrën se si është konceptuar.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Zonja Gjermani, urdhëroni!

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër për prezantimin!

Ju përgëzoj, në radhë të parë, për konsistencën dhe për vazhdimësinë e këmbënguljes suaj në lidhje me realizimin e planit të veprimit për diasporën dhe migracionin, pikë e të cilit ishte edhe ndryshimi ligjor që ju sillni.

Në vijim të asaj që tha kolegja Gjoshë, edhe unë doja t'ju pyesja në mënyrë më specifike lidhur me konsultimet me grupet e interesit, kryesisht me bashkitë.

Ju përmendët këshillin për të cilin keni diskutuar. Besoj se aty nuk janë të gjithë përfaqësuesit. Mbase janë vetëm përfaqësuesit e bashkive, njësitë vendore, dhe konsultimi për mua do të rezultonte në prezantimin e ndryshimeve të projektligjit dhe dhënien e mendimit nga të gjitha njësitë vendore lidhur me këtë strukturë të re, nëse ka pasur komente, sugjerime apo përvoja dhe nëse janë marrë në konsideratë apo jo.

Ndërkohë që këtu përmendet se nuk ka faturë financiare, unë kam një pyetje në lidhje me këtë. Si do të vazhdojnë të funksionojnë apo të krijohen struktura të reja, në qoftë se nuk ka mjete financiare të alokuara për këtë gjë? Është e vështirë, në fakt. Pas reformës territoriale administrative, njësitë vendore kanë marrë shumë përgjegjësi, edhe të deleguara nga pushteti qendror. Në këto kushte i shtojmë edhe një tjetër. A kanë kapacitetet e nevojshme apo jo? A do të trajnohet për këtë gjë apo jo? Ato struktura nëse ekzistojnë në njësitë vendore dhe i japin këto shërbime për qytetarët shqiptarë që janë brenda vendit, që nuk kanë emigruar, vallë nuk i kanë kapacitetit dhe mundësitë ta bëjnë këtë gjë edhe për ata që kthehen nga emigracioni, apo për diasporën? A mund t'i rrisim kapacitetet e tyre duke i trajnuar apo duke u dhënë një mundësi për ta bërë këtë gjë?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Urdhëroni, zonja Hajdari!

Rudina Hajdari – Mirëmëngjesi, zoti Majko!

Faleminderit juve, që jeni të pranishëm!

Unë ndaj të njëjtin mendim me zonjën Gjermani. Mendoj se është pak e pabesueshme që të mos ketë efekte financiare, se nëse ju pretendoni të hapni zyra, besoj se ato duhet të kenë një punonjës, minimumi. Përveç kësaj, nga ana teknike, është një gjë të cilën mund ta zgjidhni fare lehtë.

Unë dua të bëj disa pyetja substanciale, meqë thoni se do të bëni ndërhyrje te ligji “Për qeverisjen vendore” për të ndihmuar diasporën apo emigrantët të cilët kthehen në Shqipëri.

Pyetja e parë është një pyetje e natyrshme: a keni folur ju me diasporën, me këtë grup që është rikthyer dhe a i keni pyetur ata se çfarë shërbimi kanë dëshirë t’u ofrojë qeverisja vendore? E vërteta është se kemi zyra punësimi dhe lloj-lloj zyrash të tjera të hapura nga qeverisja vendore apo qendrore, por këto zyra nuk kanë një lloj funksioni dhe në parim janë zyra, të cilat i shtojnë burokracitë, madje edhe tatimet e ndryshme që duhet të paguash për një shërbim apo për një tjetër i shtojnë burokracitë dhe nuk shërbejnë absolutisht për gjë. Prandaj pyetja ime është: si do të funksionojnë këto zyra? Vërtet mendoni se do të keni rezultate duke hapur këto zyra? Domethënë, çfarë do të ofroni ju për diasporën? Për shembull, nëse do të bëni një zyrë informacioni për bizneset, është në rregull. Nuk besoj se i ka ndaluar deri tani ligji që emigrantët të hapin një lloj biznesi. Nuk besoj se ata nuk kanë njohuri, sepse shumica janë njerëz të shkolluar, të cilat kanë njohuri shumë të sakta dhe e dinë fare mirë se si hapet një biznes, se ku duhet të shkojnë dhe ku duhet ta marrin atë lloj informacioni.

Pra, një zyrë që nuk ka asnjë lloj funksioni është e tepërt dhe është thjesht një trukim që i bëni qeverisë suaj për të thënë se po merreni edhe me emigrantët që po kthehen. Të jeni të vetëdijshëm se njerëzit që kthehen janë shumë të zgjuar dhe vërtet e kuptojnë se si funksionon kjo qeveri, ky vend dhe kanë kritikën e rezervat e tyre. Besoj se duhet të konsultoheni me ta për të dëgjuar kërkesat e tyre, pastaj hajdeni e propozoni një ligj dhe thoni se ky është ligji i duhur për ta për t’u ofruar shërbime, sepse kështu bën sens. Pra, mos hajdeni me një ligj, i cili është thjesht një trukim dhe nuk sjell asnjë risi.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Hajdari!

Fjalën e ka zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe unë, në radhë të parë, dua të shpreh mbështetjen për këtë projektligj. Natyrisht që është një iniciativë shumë pozitive, argumentet e së cilës i kemi dhënë qëkur u krijuan Ministria për Diasporën, Agjencia për Diasporën e kështu me radhë, kështu që nuk është nevoja

t'i përsëritim dhe një herë. Në lidhje me shqetësimin që shprehën kolegët për sa u takon efekteve financiare, dua të shtoj se këtu nuk bëhet fjalë vetëm për kapacitete njerëzore shtesë për hapjen e zyrës, por bëhet fjalë për shërbime shtesë që ofrohen. Për shembull, te neni 1 i këtij projektligji, që i shton një pikë nenit 29, pika “b”, thuhet se bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve dhe një ndër to është nxitja e organizimeve brenda dhe jashtë vendit për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm etj. Kur flasim për aktivitete shtesë, patjetër që ka një kosto financiar. Ndërkohë, thuhet që ligji hyn në fuqi menjëherë. A kanë parashikuar bashkitë në buxhetet e tyre aktivitete që lidhen me këtë projektligj, apo jo?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti Ministër, do të dëgjojmë pyetjet dhe komentet e kolegëve, pastaj do ta merrni fjalën?

Pandeli Majko – Si të dëshironi ju!

Mimi Kodheli – Zoti Hyseni.

Pastaj e ka fjalën zonja Hysi.

Alket Hyseni – Zoti Ministër, ju falënderojmë për këtë projektligj, i cili vjen në vazhden e punës dhe përpjekjeve të ministrisë suaj, por edhe të qeverisë “Rama” për risjelljen e emigrantëve në vëmendje të shtetit shqiptar!

Ky projektligj, ashtu sikurse edhe ju e theksuat, është një projektligj që ka nevojë për një shumicë të cilësuar. Për këtë arsye mendoj se kërkon edhe konsultën e cilësuar në këtë rast. Patjetër që kërkohet edhe ndihma e kolegëve të opozitës, të cilët, fatmirësisht, i kemi pjesëmarrës edhe në komisione, edhe në seancë. Për këtë arsye, ashtu sikurse ju thatë, janë bërë konsulta me grupe të caktuara interesi, edhe pse mund të ketë vend për plotësim edhe me grupe të tjera interesi. Besoj se për disa aspekte ka nevojë që të konsultohemi dhe të arrijmë konsensusin me opozitën.

Në radhë të parë, për qëllimin mendoj se kolegët e opozitës, edhe nga diskutimet që po dëgjojmë, nuk janë kundër. Nuk besoj se është ndonjë shqiptar kundër idesë për të lehtësuar dhe për t'i shpeshuar kontaktet e shtetit shqiptar me diasporën, me emigrantët shqiptarë, kudo që janë, dhe për t'u ofruar disa shërbime minimale në organet e pushtetit vendor kësaj kategori të emigrantëve, por po shoh se ka diskutime në qoftë se janë mekanizmat e duhur dhe nëse janë instrumentet e duhura. Nga ana tjetër, nuk kemi pse ta fshehim që, nëse ka nevojë për një kosto financiare, sepse nuk ka shërbime që mund të kryhen pa një kosto financiare, nuk duhet të hezitohet. Qeveria shqiptare është në gjendje të sigurojë koston financiare përkatëse, në mënyrë që këto që themi të mos mbeten në aspektin propagandistik, por të kthehen në shërbime reale dhe efektive në terren, sepse ka raste që ne bëjmë ligje ose akte të tjera nënligjore, por në

fund nuk realizohet synimi i atyre akteve. Pra, duke involvuar edhe shqetësimin që ngritën disa nga shokët, duke shtuar edhe shqetësimin tim për sa i takon mendimit të marrë nga Ministria e Financave, që nuk e shikoj në relacion, dua të pyes nëse është marrë mendimi i Ministrisë së Financave në dy aspekte: së pari, në aspektin e kostos financiare, e cila besoj se është e pashmangshme, jo thjesht në disa numra të personelit për strukturën e posaçme, më tepër për pikën dy, lidhur me nxitjen e organizimeve brenda dhe jashtë vendit, që besoj se kanë kosto të konsiderueshme. Të organizosh aktivitete, të suportosh aktivitete ekonomike, kulturore dhe arsimore me emigrantët ka kosto, duke shtuar këtu kostot infrastrukturore për ngritjen e kësaj strukture dhe të burimeve njerëzore, mendoj se kërkohet një faturë financiare dhe një mendim të Ministrisë së Financave.

Së dyti, këtu keni parashikuar shtyrjen e afatit për llogaridhënien lidhur me shpenzimet e pushtetit lokal deri më 31 maj, gjë që mund të sjellë konsekuenca për sa u takon raportimeve të përgjithshme në kuadër të ligjit të buxhetit të shtetit në Ministrinë e Financave për llogaritjen e elementeve makroekonomike të vendit. Kjo ka nevojë për një konsultim me Ministrinë e Financave, nëse cenon atë ministri, Institutin e Statistikave për të dhënat e tjera dhe këdo institucion shtetëror, i cili involvohet direkt apo indirekt nga ky proces.

Politikisht, ftoj kolegët e opozitës ta sigurojnë mbështetjen për këtë projektligj. Nuk ka më justifikime për asnjë nga palët në emigracion. Jo më larg se javën që kaloi isha në Athinë, ku zhvillova takime me emigrantët, duke qenë se unë dhe kolegu Marto jemi nga një qark, i cili ka numër shumë të lartë emigrantësh, sidomos në territorin grek, ku emigrantët tashmë janë bërë më kërkues, janë bërë më të vetëdijshëm për rolin e tyre që kanë në shoqërinë shqiptare, në shtetit shqiptar, duke filluar që nga niveli i familjeve të ngushta nëpërmjet dërgimit të reminitancave, por edhe shumë më tepër se kaq, roli i tyre si ambasadorë të Shqipërisë ka të bëjë me ndërtimin e një jete të suksesshme, që shpesh kanë tejkaluar dhe ritmet e shtetit shqiptar.

Po ashtu, zoti Ministër, në fund të vitit të kaluar ishim në Angli, në një takim me emigrantët, dhe konstatuam që një pjesë e madhe e emigrantëve shqiptarë, përtej asaj që disa medie të caktuara jashtë vendit dhe brenda vendit të kryqëzuara edhe me njëra-tjetrën në sinkron, përpiqen të njollosin imazhin e emigrantëve shqiptarë. Ata kanë tejkaluar edhe vetë qytetarët e atyre shteteve ku janë nëpërmjet shembullit të suksesit të arsimimit e fëmijëve, shembullit të suksesit në ndërtimin e ekonomive të tyre familjare, shembullin e suksesit në kontributet e tyre në qytetari. Për këtë arsye ne duhet të jemi krenarë për t'u ofruar atyre shërbimet që këtu parashikohen, si dhe shumë shërbime të tjera.

Nga ana tjetër, të thithim prej tyre sa më shumë informacion, sepse ata kanë bagazhe, tashmë kanë arsimuar me dinjitet fëmijët e tyre, të cilët ne duhet të gjemë forma t'i thithim, t'i sjellim këtu, ashtu siç po krijojmë mënyra për të stimuluar studentët e shkëlqyer, pse jo të stimulojmë edhe fëmijët e emigrantëve këtu, qoftë edhe në këto struktura të posaçme. Pra, mund të punësohen drejtpërdrejt fëmijë emigrantësh që kanë dëshirë të vijnë. Prandaj them se ka nevojë edhe për pak konsultë më të zgjeruar për të arritur synimin dhe akordin.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër!

Besoj se jeni një ndër ministrat që keni qenë pa reshtur në këtë komision dhe keni sjellë një sërë projektligjesh, strategji dhe keni bërë edhe raportime, për këtë gjë ju përgëzoj shumë.

Lexova me vëmendje propozimin, projektligjin dhe argumentet për projektaktin dhe ju në relacion theksoni dy argumente:

Së pari, nevojën e ndërmarrjes së masave në nivel vendor për realizimin e të drejtave politike, ekonomike dhe social-kulturore.

Së dyti, dhënien e informacionit, i cili rezulton i pamjaftueshëm për adresimin e nevojave të diasporës në nivel vendor.

Pyetja e parë ka të bëjë me faktin, megjithëse është një ministri që është formuar para një viti e gjysmë, nëse keni ndonjë studim apo informacion lidhur me shkallën e zhvillimit të bashkëpunimit të bashkive në përgjithësi dhe bashkive ndërkufitare në veçanti lidhur me projektet e zhvillimit dhe shkëmbimit kulturor me diasporën në rajon dhe më gjerë.

Së dyti, ne kemi një program transparence, ku çdo institucion qendror dhe vendor duhet të ofrojë në faqen zyrtare dhe nëpërmjet zyrave të marrëdhënieve me publikun informacion të detajuar për shërbimet që ofrohen në nivel vendor dhe qendror. Në këtë kuadër, regjistrimi dhe fitimi i shtetësisë është në portalin e Ministrisë së Brendshme, në portalin e Ministrisë për Europën e Jashtme dhe në shërbimet konsullore, të cilat janë shumë të detajuara dhe të pasqyruara qartë në faqen e konsullatave dhe në faqen e Ministrisë për Europën dhe Punën e Jashtme. Gjithashtu, Qendra Kombëtare e Biznesit ka një faqe të pasur më të gjithë hapat që ndërmerren për të regjistruar një biznes, qoftë për investitorët vendas, ashtu edhe për të huaj.

Së treti, në faqet e bashkive jepet i gjithë informacioni për shërbimet që ofrohen në nivel bashkie dhe si mund të aplikohet për të marrë një certifikatë, një kartë identiteti e të tjerë. Në vlerësimin tuaj, i gjithë ky program transparence, i cili ekziston dhe monitorohet në mënyrë sistematike nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, a e përmbush nevojën për informacion ndaj diasporës?

Pyetja tjetër lidhet me një propozim në nenin 2 të projektligjit për konsultimin publik. Ne kemi kaluar një ligj të konsultimit publik, i cili është i gjashti në botë për nga cilësia, janë 6 vende që kanë ligjin më të mirë. Ligji i konsultimit publik është një ligj i mirë, sepse është shumë i gjerë dhe i detajuar në procesin e konsultimit. Megjithatë, nga raportimet e bëra në Komisionin e Ligjeve nga institucionet e pavarura rezulton se është i vështirë për t'u realizuar. Këtu sjell edhe shqetësimin që ngritën zonja Gjermani dhe zonja Hajdari, që duke dashur të bëjmë ligje sa më moderne dhe më të mira ndonjëherë nuk u krijojmë mundësi institucioneve për t'i respektuar ato, ku dalin edhe raporte vlerësimi jo të përshtatshme. E gjithë kjo ndodh jo se njerëzit nuk duan, por nuk janë mundësitë dhe i kemi ngarkuar me shumë kompetenca. Si e mendoni ju konsultimin publik të përfaqësuesve të diasporës? Afati i konsultimit publik është 15 ditë maksimumi, për ligje të vështira mund të shtohet afati, por çfarë do të ndodhë me punonjësit për moskonsultimin në kohë të projektligjit dhe dëgjimin e grupeve të interesit, sepse ju e dini që moskonsultimi në kohë ka pasoja financiare dhe mund të shkojë deri në masa disiplinore për nëpunësit në varësi të ligjit që rregullon marrëdhënien e tyre, qoftë nga Kodi i Punës apo nga ligji i shërbimit civil. Si është menduar të bëhet konsultimi i përfaqësuesve të diasporës? A do të jenë të gjithë përfaqësuesit e diasporës dhe të gjitha shoqatat, që janë të shpërndara në të gjithë globin, apo vetëm përfaqësues brenda vendit?

Së fundi, po i kthehem edhe një herë asaj që tha kolegja Gjermani, që neni 1 kërkon krijim të strukturës së posaçme, por kësaj strukture i jep 4 lloje detyrash në fusha të ndryshme: nxitje të organizimeve, dhënie informacioni për fitim shtetësie, këtu duhet të jesh jurist; dhënie informacioni për investime, që duhet të jesh ekonomist ose financier, dhe dhënie informacionit për çështjet e diasporës dhe migracionit, ku duhet të kesh një formim më të thelluar në këto çështje, që do të thotë se kjo strukturë nuk mund të ketë vetëm një person, por duhet të ketë më shumë.

A keni në plan, në kuadër të strategjisë, të ndërtoni një portal dedikuar diasporës, ku të gjendet i gjithë informacioni nga A-ja te Zh-ja për shërbimet, informacionet, nevojat, në nivel vendor dhe qendror, që të dihet se ky është portali për çdo shtetas shqiptar që jeton jashtë përkohësisht ose përgjithmonë dhe të marrë informacionin pa qenë nevoja të dublikohen të

gjitha kompetencat dhe të mbingarkojmë organet e vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë aq shumë për të bërë dhe që nuk kanë bërë atë që duhet në bazë të ligjit?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Zonja Gjebrea fjala për ju.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Sigurisht që ne e mbështesim ministrin për iniciativat që kanë të bëjnë me çështjet e diasporës, që është një prioritet dhe jemi të lumtur që kemi një ministri më vete për çështjet e diasporës. Kolegët i thanë shqetësimet, të cilat ishin çështje që unë doja t'i sillja në vëmendje,

Ajo që tha zonja Hysi besoj se duhet mbështetur. Portali ose informacioni *online* nga ministria juaj për të gjitha këto çështje, të cilat e lehtësojnë, që sigurisht duhet të ketë lidhje dhe *link* edhe me ministrinë e tjera që bëjnë punën përkatëse. Në këtë këndvështrim, për shembull, për sa i përket dhënies së ndihmës së informacionit për çështjet që lidhen me fitimin e shtetësisë, çështjet e shtetësisë janë në juridiksionin e Ministrisë së Brendshme, ku përfshihen edhe prefekturat. A do të ishte më mirë që këtë punë ta bëjnë prefekturat në nivel vendor sesa lidhja me bashkitë, e cila do ta komplikonte këtë?

Ashtu sikurse nuk është një gjë e vështirë, edhe unë bie dakord që struktura të ndryshme duhet të kryejnë disa funksione, por nuk jam për atë që janë të mbingarkuara, ndoshta kjo vjen për mungesë organizimi, sepse e shikojmë që në shumë institucione puna bëhet vetëm nga disa persona, ndërsa pjesa tjetër nuk është shumë efektive, prandaj nevojitet patjetër një mënyrë organizimi ndryshe. Nga ana tjetër, shikoj edhe një lloj diskordance, sepse, ndërkohë që flisni për përgjegjësitë e bashkive, përmendni edhe një koordinim ndërmjet bashkive me ministri të ndryshme. Më duket se e tejkalon kompetencën në këtë drejtim. Ose duhet një sqarim, ose mund të jetë diçka më vete.

Këto kisha.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zonja Kushi.

Evis Kushi – Në fakt, siç e përmendi edhe zonja Gjebrea, te neni 29/1 u morëm me pikat kryesore, që kanë të bëjnë me organizimin e eventeve apo dhënien e informacionit, ndërsa pikën e fundit, e cila mua më duket shumë e rëndësishme, e lamë pa përmendur. Thuhet: “Bashkitë janë përgjegjëse për koordinimin dhe bashkërendimin e punës me ministrinë përgjegjëse: atë për punët e brendshme, për punët e jashtme dhe për diasporën, për garantimin e dhënies...” e të tjerë. Më duket një kompetencë që nuk ka aspak lidhje me funksionin kryesor

dhe me objektivin. Kjo është diçka krejt e tepërt dhe jam e sigurt se bashkitë nuk mund ta bëjnë këtë gjë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti Ministër, përpara se t’jua jap fjalën për t’iu përgjigjur komenteve dhe pyetjeve që parashtruan kolegët, dua të nënvizoj dy gjëra të rëndësishme: njëra u përmend, në fakt, edhe nga kolegët, si dhe diçka që besoj se kolegëve u ka shpëtuar ose është anashkaluar si koment.

Për aq kohë sa në Shqipëri nuk ka, sot që flasim, një ministri të dedikuar për pushtetin vendor, ligji për pushtetin vendor ose për vetëqeverisjen vendore menaxhohet nga Ministria e Brendshme. Ndaj, unë do ta shikoja të udhës që në propozimet e ndryshimeve që vijnë për këtë ligj, pavarësisht se propozimet vijnë nga ministria juaj, të kishte të paktën një përfaqësues të Ministrisë së Brendshme ose të kishte një reagim zyrtar me shkrim nga ana e kësaj ministrie.

Sigurisht, për aq kohë sa ju keni ardhur këtu, kjo gjë është diskutuar në qeveri dhe jam e bindur, në qoftë se qeveria e ka miratuar, se ka pasur një angazhim të tillë. Por këtë jo, nuk e marrim dot *for granted*, nuk e marrim dot të mirëqenë; duam të shikojmë se çfarë ka thënë Ministria e Brendshme në këtë rast, sepse më rezulton që, në qoftë se Ministria e Brendshme nuk ka bërë vëzhgimin e saj, ka një problem shumë të madh me strukturën e ministrisë lidhur me ndryshimet që vijnë.

E dyta, në nenin 3 kërkoni të shtyhet afati i raportimit financiar, pra nga data 31 mars, në datën 31 maj. Kjo është absolutisht e pamundur. Disiplina financiare që menaxhohet nga një ligj, i cili është ligj organik dhe prevalon mbi ndryshimet që ju keni sjellë...

(Ministri Majko ndërhyrje pa mikrofon.)

...kërkoni që ky raportim të vijë në fund të marsit. Nuk mund të ketë asnjë shans, asnjë strukturë që të sjellë një raportim financiar pas kësaj date. Kështu që, unë insistoj dhe e hedh poshtë këtë ndryshim që vjen në nenin 3, pa qenë nevoja fare të dëgjoj komentet e gjithsecujt, pasi e kam shumë të thjeshtë këtë, e kam çështje të profesionit. Ndërsa, në raport me çka u tha nga kolegët mendoj se shumëçka ishte e drejtë, ndaj jam gjithë veshë të dëgjoj përgjigjen tuaj. Pastaj do të kalojmë në diskutim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Veshë në këtë rast, më shumë sesa sy.

(Diskutime në sallë)

Fjala është për ju, zoti Ministër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pandeli Majko – Mirë.

Unë ju falënderoj!

Po e filloj nga pyetja që ka të bëjë me konsultimin me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrinë e Brendshme dhe me Ministrinë e Financave.

Të nderuar kolegë,

Asnjë akt, sidomos një akt i një natyre të tillë, nuk mund të kalonte në qeveri pa komentet e këtyre ministrive. Pra, nga Ministria e Brendshme, nga Ministria e Financave dhe nga ministria përgjegjëse për politikën e jashtme. Ky është rregull, të paktën për kolegët që kanë qenë anëtarë të qeverisë, sidomos pa marrë dakordësinë e këtyre 3 institucioneve ky akt nuk mund të kalonte në qeveri thjesht si vullnet i...

Mimi Kodheli – Ne kërkuam që të ishte në relacion, zoti Ministër.

Pandeli Majko – A mund ta mbaroj unë dhe më pas të diskutojmë?

Mimi Kodheli – Ne kërkuam që të ishte në relacion, dhe nuk është.

Pandeli Majko – Në dijeninë time, nga eksperiencia ime modeste, kur vijnë projektligje në Kuvendin e Shqipërisë, nuk vijnë komente ekstra nga institucionet e tjera, por vjen vetëm një relacion i firmosur nga ministri përgjegjës dhe nga Kryeministri. Megjithatë, nëse dëshironi, jemi të gatshëm t'ju japim çdolloj informacioni lidhur me këtë çështje.

Që në krye të herës, ju thashë se kemi bërë një konsultim të përbashkët me këshillin konsultativ dhe me pushtetin lokal. Aty kanë qenë përfaqësues të MB-së, zëvendësministria Voda, si dhe zëvendësministria e Drejtësisë, ku kemi dhënë të gjitha shpjegimet për projektligjin e propozuar. Kjo do të thotë se nuk kemi të bëjmë me një iniciativë të njëanshme dhe të pakonsultuar. Kjo është një iniciativë e qeverisë e konsultuar, e koordinuar dhe i është kaluar Kuvendit të Shqipërisë sipas të gjitha rregullave në fuqi.

A kemi të bëjmë me një histori, e cila do të ketë faturë financiare në vazhdim? Mbase do të ketë një faturë financiare në vazhdim, por dëshiroj të nënvizoj faktin që ne kemi bërë një konsultim shumë të detajuar me përfaqësuesit e këshillave bashkiake. Si fazë e parë nuk rezulton të ketë ndonjë ngarkesë të jashtëzakonshme të natyrës financiare, për më shumë, që aktivitetet janë një moment subjektiv, i cili duhet planifikuar kur miratohet buxheti dhe në varësi të iniciativave të kryetarëve të bashkive. Dikush bën më shumë aktivitete, dikush bën më pak, por në çdo rast do të miratohen nga këshillat bashkiake dhe nuk është ministri për Diasporën që insiston apo cakton se sa fonde do të shpenzojnë.

Megjithatë, të nderuar kolegë, kemi të bëjmë me një kulturë të re administrative dhe unë i mirëkuptoj të gjitha dyshimet që hidhen këtu, lidhur me atë që jemi duke bërë dhe ku jemi duke ecur. Kemi të bëjmë me një kategori shtetasi, i cili e ka nivelin e informacionit më të ulët sesa ata që jetojnë këtu.

Është e vërtetë që ata kanë kulturë perëndimore, por është po aq e vërtetë që ata gjejnë këtu zyrtarë që nuk u përgjigjen.

Është e vërtetë që ata vijnë me një kulturë perëndimore, por është po aq e vërtetë që ata gjejnë këtu një legjislacion të ndryshëm nga legjislacioni i vendeve nga ku vijnë.

Është e kotë ta diskutojmë që legjislacioni i Kanadasë dhe ai i SHBA-së kanë diferenca thelbësore me legjislacionin shqiptar, që është një legjislacion përgjithësisht europian. Edhe sikur të jenë nga migracioni i Europës, është e kotë ta diskutojmë, sepse ka ende diferenca në trajtimin e problematikave. Kështu, ne na duhet që zyrat e ekspertizës të jenë një *roadmap*, pasi nuk është vetëm Tirana, e cila garanton informacion të hollësishëm për sa i përket kësaj shtrese njerëzish. Dëshiroj të nënvizoj se edhe trupa e donatorëve të huaj, të cilët janë të interesuar për problemet e decentralizimit, për marrëdhëniet e pushtetit vendor me qytetarët, na kanë dhënë përkrahje.

A do të ketë trajnim lidhur me këtë çështje? Patjetër. Do të ketë donatorë të gatshëm, të cilët do të jenë të prirur për të ndihmuar këto zyra, të cilat siç e thashë janë si të diasporës edhe të migracionit.

E përsëris edhe një herë se është një shtresë e veçantë e shoqërisë shqiptare, e shtetasve shqiptarë, të cilët nuk jetojnë këtu. Ne kemi një administratë, e cila pretendon në shumicën e rasteve se shërbimet u takojnë vetëm atyre që jetojnë në Shqipëri, kur duhet të jetë edhe e kundërta.

Diskutojmë problemet e natyrave konsultative. A kemi folur me diasporën? Të jemi të sinqertë. Diaspora shqiptare është e shpërndarë nga Alaska deri në Australi. Imagjinoni se çfarë do të thotë, sikur ta marrim *mot a mot* ligjin për konsultimin publik, se çfarë duhet të bëjmë ne, a duhet t'i marrim me radhë të gjitha vendet dhe të kthehemi në ambasadorë shëtitës për të konsultuar projektligjin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta vazhdojmë pak.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta vazhdojmë!

Në qoftë se do ta marrim *mot a mot* ligjin për konsultimin publik, atëherë i bie të veprojmë kështu. Problemi është më esencial. Në shoqërinë civile ne kemi shumë pak grupe të interesuara për këtë çështje. Nuk kemi pasur as grup donatorësh, siç ekzistojnë në Kosovë dhe as shoqëri civile të interesuar për këtë çështje. Ne jemi të detyruar të bëjmë memorandum të veçantë me grupin “Germin” në Kosovë, që ndoshta është rrjeti ndërkombëtar më i plotësuar

me rrjetet profesionale të shqiptarëve pa dallim, qofshin të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë apo Malit të zi. Uroj të kemi me ta konsultim permanent.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë ka?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thashë që është shoqëri civile, zonja kryetare e komisionit. Unë nuk hyj te njerëzit që bëjnë gabime të natyrave të tilla.

Për sa i përket çështjes së informacionit, mendoj se të gjithë kolegët e trajtuan. Ne jemi në negociata me Bankën Botërore për të hapur një faqe të veçantë, e cila nuk do të jetë në disponim të qeverisë, por me një trupë profesionale gazetarësh, të cilët nuk jetojnë vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë vendit. Tani jemi në fazën e negociatave, por nëse do t'ia arrijmë do të jetë një projekt goxha i suksesshëm.

Për sa i përket çështjes se si do të organizohet informacioni në vazhdim, Kryeministri ka firmosur ngritjen e një grupi pune me të gjithë përfaqësuesit e AKSHI-t, të cilët po bëjnë një punë të detajuar duke përcaktuar edhe një koordinator kombëtar për këtë çështje, me qëllim që çështja e informacionit të mos shikohet si një çështje informacion. Kemi të bëjmë me njerëz që nuk janë këtu, por që janë shumë të interesuar për çfarë ndodh këtu. Po diskutohet që çdo faqe, e cila mbulon interesa apo shërbime të shtetasve tanë që jetojnë jashtë vendit, të ketë elemente të veçanta të dhënies së informacionit për çdo ministri apo agjenci të interesuar.

Zonja kryetare e komisionit, dëshiroj të nënvizoj edhe një fakt: Nuk do të isha këtu nëse do të kisha vajtur pa opinionin e përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Jashtme në Këshillin Konsultativ të Pushtetit Lokal. Është e pamundur. Të shkosh në mënyrë të tillë është aventureske.

Në këtë pikëpamje, dua të them fjalët më të mira për përfaqësuesit e Partisë Demokratike, apo të tjerët (këtu kam parasysh pjesën e maxhorancës socialiste), të cilët kanë dhënë suportin maksimal për këtë dhe nuk kanë ngritur aludime apo çudira të natyrave të tilla siç po ndesh sot në komision.

Po flasim për një kategori njerëzish, të cilët janë jashtëzakonisht të interesuar dhe duan informacion, detaje dhe zyra ku të trokasin.

Kur ndodhi kriza ekonomike në Greqi, sipas statistikave të përgjithshme, në Shqipëri u kthyen mbi 120 mijë veta. A ishim të gatshëm ne të merreshim me ta? Sipas statistikave 70% e tyre janë larguar sërish, sepse infrastruktura e trajtimit të interesave të tyre nuk përgjigjej. Sepse ne kemi një administratë, e cila një vit më parë për sa i përket çështjes së diasporës kishte vetëm një nen në ligjin e arsimit parauniversitar. Vetëm për një vit kemi kaluar tre projektligje,

ka pasur një strategji të migracionit që kërkonte krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës që në vitin 2005 dhe nuk u ngrit. Që nga viti 2010 kemi qenë pa strategji. Për të mos folur për gjëra të tjera. Nëse ne diskutojmë sot për të drejtën e votës dhe i trajtojmë shtetasit tanë jashtë vendit që me interesat e tyre të përfaqësohen në shoqërinë shqiptare, mendoj se kjo që po diskutojmë sot është pjesë e infrastrukturës së domosdoshme, e cila nuk është dëshirë, por bazohet mbi modele të natyrshme. Unë ju mirëkuptoj dhe jam i hapur për çdo lloj ndryshimi.

Mimi Kodheli – Ministër, jemi të interesuar për nenin 3.

Pandeli Majko - Jo, do të mbaroj njëherë atë që kam për të thënë për ligjin.

Mimi Kodheli - Neni 3 është më i rëndësishëm.

Pandeli Majko – Pse është neni 3 më i rëndësishëm sa ligji?

Mimi Kodheli – Sepse do të bjerë. Nuk besoj se do të miratohet.

Pandeli Majko – Atëherë, pse e bëni pyetjen?

Mimi Kodheli – E kisha retorikë.

Pandeli Majko – Unë nuk kam ardhur për retorikë këtu.

Mimi Kodheli – Retorika në politikë është pjesë e ...

Pandeli Majko – Propozimi për datën, meqenëse insistoni, nuk është nga zyra ime, por nga një zyrë tjetër.

Në procesin e konsultimit që bëhet normalisht për çdo projektakt para se të kalojë në Këshillin e Ministrave, siç jua thashë, projektakti kalon nëpër disa ministri. Ky është komenti im për atë që pyetët.

Mimi Kodheli – Mund të vazhdoni nëse keni ndonjë gjë tjetër.

Pandeli Majko - Jo, në qoftë se ka ndonjë koment nga kolegët.

Dëshiroj t'jua them edhe një herë, mbetem i hapur për çdo lloj ndryshimi, sugjerimi konstruktiv, i cili ka të bëjë me kalimin e këtij projektligji, për më tepër që ky projektligj nuk mund të kalojë pa votën e cilësuar prej 3/5-ve. Ju siguroj që ka vetëm një qëllim, qëllimin e mirë. Që nga muaji korrik kemi qenë në pritje të opinionëve të çdo bashkie. I kemi kërkuar me insistim Këshillit Konsultativ një opinion deri në fillim të muajit shtator. Vetëm në muajin shtator kemi filluar procedurën e kalimit të projektligjit për opinion nëpër institucione, të cilat mbulojnë interesat e këtij projektligji, siç jua thashë në Ministrinë e Jashtme, në Ministrinë e Brendshme dhe në Ministrinë e Financave. Po jua ritheksoj se në Këshillin Konsultativ kam qenë së bashku me përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, sigurisht edhe me përfaqësues të tjerë.

Mimi Kodheli – Ju faleminderit, zoti Ministër, për shpjegimet që na dhatë!

Para se t'ia jap fjalën zotit Hyseni për procedurë dhe më pas kolegëve të tjerë për komentet e tyre, dua të bëj një koment.

Nëse nuk ju kuptova gabim, ju thatë se në konsultimet me strukturat ose organizmin drejtues të institucioneve të tjera ku keni shkuar, për të diskutuar me shoqatat e bashkive si më të interesuarat për ndryshimet që ju keni sjellë, thjesht dhe vetëm, këtë radhë jo për retorikë, dua t'ju kujtoj se edhe ne jemi po aq përfaqësues të popullit saç janë edhe kryetarët e bashkive. Kur vijmë këtu, kur komentojmë, kur kundërshtojmë apo miratojmë e bëjmë në emër të tyre dhe për të mirën e tyre po aq sa edhe bashkitë në mos pak më tepër.

Zoti Hyseni, fjala për ju.

Kishit diçka për procedurë?

Alket Hyseni – Po.

Faleminderit!

Nisur nga diskutimet e fundit dhe nga shpjegimet e ministrit, me shqetësimin e një deputeti sikurse folët, ndoshta unë dhe zoti Balla jemi të vetmit deputetë, të cilët kanë zyra deputetësh jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë falë edhe mbështetjes së emigrantëve atje ku janë, një në Athinë, që e kam unë dhe një në Selanik, që e ka zoti Balla. Do të doja që ta kuptoni, sepse ne jemi një zë i fuqishëm i emigrantëve si deputetë, po ashtu edhe përfaqësues të komuniteteve, sikurse tha edhe kryetarja e komisionit, prandaj do t'ju sugjeroja që edhe zëri ynë të ketë vendin e vet të konsiderueshëm, zoti Ministër.

Për këtë arsye, proceduralisht, do të doja të ndërhyja me sugjerimin që ligji të miratohet sot në parim, ndërsa votimi nen për nen të shtyhet për t'i lënë kohë ministrisë që t'u përgjigjet shqetësimeve që ne kishim këtu, Ministrisë së Financave ndoshta për të sjellë komentet e veta, për t'i dhënë kohë opozitës për të parë se sa e gjen veten në këtë projektligj dhe në këtë qëllimi të mirë që ka. Të gjithë ramë dakord që qëllimi është absolutisht i mirë, ka disa momente teknike ku palët nuk bien dakord, prandaj do t'ju sugjeroja, zonja kryetare, ta miratojmë në parim, pasi parimi ka lidhje me qëllimin dhe t'u lëmë kohë të gjithë aktorëve për diskutimin nen për nen dhe në tërësi në mbledhjen tjetër të komisionit.

Nga ana tjetër, më lejoni, t'ju përmend një element të rëndësishëm historik, sot është 100-vjetori i vdekjes së një shtetari të madh shqiptar, ndoshta shtetarit më të madh shqiptar, Ismail Qemalit. Në bazë të ligjit, zonja kryetare, edhe në këtë komision duhet të jetë fotografia e tij, prandaj do t'i propozoja komisionit 1 minutë heshtje në nderim të kujtimit dhe të veprës së tij, si dhe do të uroja që secili nga ata që angazhohet në politikë të gjejë te ky personazh i pakrahasueshëm shembullin e mirë për t'u ndjekur.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Unë besoj se propozimi juaj ia vlen.

Ju faleminderit, kolegu Hyseni, që e sillni realisht në vëmendje këtë ngjarje të shënuar, të një simbolike të padiskutueshme të historisë dhe të pavarësisë së atdheut tonë të dashur!

Nuk besoj se ka pasur ndonjë rast tjetër të tillë, por sot është ditë e enjte dhe këtë gjë duhej ta kishim bërë në parlament, por meqë nuk ka seancë bashkohem me propozimin tuaj për të mbajtur 1 minutë heshtje për Ismail Qemalin, në 100-vjetorin e largimit të tij nga jeta!

Më pas, koleget Hajdari, Gjebrea dhe ministrja Gjoshja kishin diçka për të thënë.

(Deputetët e Komisionit për Politikën e Jashtme mbajnë një minutë heshtje).

Rudina Hajdari – Zoti Majko, kisha vetëm një pyetje në lidhje me atë që përmendët: së pari, e kuptoj frustrimin tuaj, por kjo nuk vjen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo që ndjeni për shkak të mosvajtjes apo mosshtrjes së disa propozimeve që keni bërë, për mënyrën si funksionon ministria juaj, qoftë buxheti, stafi, apo problematikat që keni hasur brenda partisë suaj, nuk ka lidhje as me ne, as me këtë ligj. Pyetjet që sapo bëra, ku përmenda grupin e interesit, të cilat u ndanë edhe nga zonja Hysi dhe zonja Gjermani, kishin lidhje me emigracionin apo emigrantët që janë kthyer në Shqipëri. Nuk është nevoja të kaloni në ironi e të thoni se nuk kemi se si të marrim përsipër të flasim me dikë që jeton në Amerikë apo në Kanada. Ky ishte komenti juaj, në mos gaboju.

Pyetja ime konkrete është: a e dini sa kushton të konvertohet një diplomë në Shqipëri? Mund të na thoni sa është çmimi për të konvertuar një diplomë të huaj?

Pandeli Majko – Megjithëse është jashtë fushës sime të përgjegjësisë, me sa di, tarifa është 2500 lekë të rinj me postë.

Mimi Kodheli – Zoti Ministër, ju lutem! Do të mbarojnë me pyetjet zonjat Gjoshja e Gjebrea, pastaj do të përgjigjeni ju.

Klajda Gjoshja – Pavarësisht pyetjeve që u bënë, do të doja t'i thosha zotit Hyseni se nuk i takon vetëm opozitës të reflektojë për ndryshimet në projektligj, por reflektimi duhet të fillojë nga Ministria për Diasporën, që ka paraqitur ndryshimet dhe të marrë parasysh, pse jo, edhe çudirat që thotë Komisioni i Jashtëm, sepse, në fund të fundit, kjo është detyra dhe funksioni ynë për të parashtruar të gjitha ato ndryshime, ashtu siç i mendojmë ne, gjithmonë në të mirë të qytetarëve shqiptarë, por edhe më shumë atyre të diasporës, së cilës i kemi një borxh të madh gjatë gjithë këtyre viteve. Mendoj që sot ta diskutojmë projektligjin në parim, por nen për nen besoj se do të duhet kohë dhe reflektim, në radhë të parë, nga Ministria për Diasporën.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Fjala për zonjën Gjebrea.

Elona Gjebrea – Faleminderit!

Zoti Ministër, te relacioni, në pikën 8, thuhet: “Ministritë, institucionet dhe subjektet e tjera, që kanë kontribuar në hartimin e projektaktit”. Ne të gjithë e dimë se si përgatitet një projektakt dhe në rastin konkret përmendet vetëm Ministria e Shtetit për Diasporën, ndaj sugjeroj që të shtohet edhe një fjali në qoftë se jeni konsultuar edhe me ministritë e tjera.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Fjala për zotin Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Për procedurë, që të ishim më operative, në vijim edhe të fjalës së zonjës Gjoshë, do të doja të ftoja anëtarët e komisionit që sot ta kalojmë në parim projektligjin.

Në cilësinë e relatorit të projektligjit do të doja të ftoja të gjithë përfaqësuesit e opozitës, që, pasi ta kalojmë në parim, të sjellin të gjitha vërejtjet dhe propozimet e tyre, që kur ta kalojmë nen për nen, të jetë i gjithëpranuar nga anëtarët e komisionit.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Në zbardhjen e procesverbalit do të shikojmë që ka pasur komente, kundërshti apo aprovime të ndryshme. T’ju them të drejtën, para se ta hedhim projektligjin në votim, dua të nënvizoj se nuk i heq asnjë presje komentit që bëri zonja Hysi. Në gjykimin tim, si deputete e Kuvendit të Shqipërisë, mendoj se janë në mënyrë absolute të gjitha ato çka kërkohen lidhur me funksionimin e bashkive apo të strukturave të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme nëpërmjet zyrave të gjendjes civile, ose QKR-së, ose të gjitha strukturave të tjera është *online* i gjithë informacioni, AIDA po të doni ka strukturat e veta, Ministria për Sipërmarrjen ka një strukturim të tillë, që e jep këtë informacion lidhur me çfarë është e nevojshme të pajiset një qytetar shqiptar që kthehet nga emigrimi ose një qytetar shqiptar që bën pjesë sot në atë që ne e quajmë diasporë. Megjithatë, biem dakord që, mbase për shkak edhe të shtytjes që i kemi dhënë këtij procesi, duke krijuar edhe një ministri dedikuar për diasporës, mund të ketë nevojë për disa ndryshime.

Unë ju përgëzoj për vendimmarrjen për të ndryshuar disa gjëra, sidomos nenin 29 të ligjit të vetëqeverisjes vendore, me shpresën që gjithçka që ne kemi thënë sot do të mund të përmblihet dhe do t’iu ridërgohen si komente të këtij komisioni, ashtu si edhe të komisionit përgjegjës, që është Komisioni i Ligjeve, t’i kalojmë sot këto ndryshime vetëm në parim, me besimin që do të rivijë, ky propozim me disa ndryshime. Insistoj që herën tjetër, me gjithë që nuk është nga zyra juaj, neni 3 të mos ketë nevojë të ndryshohet, sepse nuk mund të ndryshohet

për aq sa ligji për financat publike është një ligj që mirëpërcakton që raportimi financiar të mbyllet në datën 31 mars, ndërkohë do t'ju lutesha të mundësoni ndryshime në buxhet.

E gjitha në fund të këtij diskutimi lidhet me ndryshimet buxhetore. Pra, ose do të na sillni komentin e Ministrisë së Financave, bashkë me komentet e tjera, ose me ndryshimet e tjera ose përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe një përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Brendshme do të jenë herën tjetër prezent në komision për të na mundësuar sqarime të mëtejshme. Unë besoj se kjo është një mënyrë e drejtë për t'i përqafuar ndryshimet dhe qëllimin e mirë me të cilin keni ardhur sot, zoti Ministër.

Kështu që kalojmë në votimin në parim. Kush është dakord me ndryshimet? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ndërkohë, kemi fituar të drejtën që të rishihemi, mbase jo domosdoshmërisht me ju, Ministër, duke reflektuar të gjitha ndryshimet për të cilat kemi folur sot.

Pandeli Majko - Unë përkrah çdo lloj iniciative të komisionit, dua ta nënvizoj këtë, për çfarëdo lloji ndryshimi, i cili është në funksion edhe të votimit që ju bëtë në parim të projektligjit. Do të jem këtu siç e kam respektuar dhe vazhdoj ta respektoj këtë komision me cilindo përfaqësues të çdo institucioni, nga i cili, së bashku me mua, do të kërkon informim të detajuar për çdo hap të hedhur për miratimin e këtij projektligji. Në bazë të procesit, ne jemi të gatshëm bashkë me relatorin e projektligjit të japim çdo lloj informacioni të nevojshëm për çdo detaj ose pyetje që kanë anëtarët e komisionit.

Mimi Kodheli – Ju faleminderit, Ministër!

Diçka që më duhet ta nënvizoj dhe do të duhet shënuar në procesverbalin e mbledhjes së sotme është që projektligji ka ardhur me mungesë të një neni, i cili duhet të jetë: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”, pra duhet të jetë nen më vete. Nuk mund të jetë pjesë e ndryshimeve të nenit 3.

Pandeli Majko- Kjo është çështje e teknikës legjislative.

Mimi Kodheli- Po, më duhet për rekord të procesverbalit të mbledhjes të shënohet, kështu që duhet të vijë i shkruar ashtu siç duhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, duhet të jetë edhe në diskutimet nen për nen, por pse i paraprijmë kësaj gjëje neni 3 të mos jetë dhe në nenin 3 të jetë: “Ky ligj hyn në fuqi menjëherë”. Megjithëse, të them të drejtën, zonja Kushi me të drejtë paraqiti shqetësimin që ky ligj hyn në fuqi menjëherë, nuk e di si do të ndryshojë struktura e çdo bashkie menjëherë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra edhe nëse është 15 ditë, i duhet lënë një kohë.

Gjithsesi do të kemi diskutimin nen për nen të tij.

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA